



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 43 prot.

Kamëz, më 23.4 .2026

V E N D I M
Nr. 38 .Datë 23/4 2026

MBI
“NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË NJË RRUGE NË TERRITORIN E
BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.04.2026, pasi mori në shqyrtim kërkesën për ndryshimin e emërtimit të një segmenti të rrugës; “Aron Duraku” në “Harku i Triumfit” me Nr.Prot 4279 datë 21.04.2026 , në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “II” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004,“Për sistemin e adresave”, të ndryshuar; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I :

1. Emërtimin “Harku i Triumfit”, segmentit të rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015,“Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI